

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

“BILLA HOME” Sh.p.k.

Në Tiranë, sot më datë 10.09.2018.

1. Shefqet Billa, i biri i Arifit, i datëlindjes 11.01.1952 me karte identiteti F20111018V, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë
2. Jetmir Billa, i biri i Shefqetit i datëlindjes 19.05.1983 me kartë identiteti I30519198O, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë.
3. Ideal Billa, i biri i Shefqetit i datëlindjes 16.08.1979, me kartë identiteti H90816120C lindur në Kukës dhe banues në Tiranë.
4. Arif Billa, i biri i Shefqetit i datëlindjes 02.04.1987, me kartë identiteti I70402078M lindur në Kukës dhe banues në Tiranë.
5. Znj. Arjeta Billa, e bija e Shefqetit e datëlindjes 16.10.1990 me kartë identiteti J06016043P lindur në Kukës dhe banuese në Tiranë.

Në bazë të vullnetit tonë të lirë dhe mbështetur në Ligjin 9901 datë. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe veçanërisht neni pika 2, dhe ligjin 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” vendosëm të themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara që do të veprojë sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është “BILLA HOME” Sh.p.k.

Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brëndshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "Billa Home" Sh.p.k., sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi si dhe në Statutin vijues.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktiviteti ekonomik në fusha të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në vijim në këtë kontratë si dhe në Statutin e saj. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "Billa Home" Sh.p.k. Ajo do të ketë edhe vulën e saj me po këtë emër.

NENI 4

Objekti veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt veprimtarisë të saj:

- Import-eksport dhe shitje me shumicë dhe pakicë të mobiljeve dhe pajisjeve shtëpiake. Shoqëria mundet gjithashtu që të prodhojë me qëllim që të tregtojë me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit mobilje dhe pajisje shtëpiake.
- Shoqëria mund të kryejë aktivitete Import-eksport, prodhimi dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave e lëndëve të para për industrinë e ndërtimit brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të tretëve.
- Ndërtime të ndryshme civile, industriale, social-kulturore të të gjitha llojeve, ndërtim, shitblerje dhe menaxhim të pasurive të paluajtshme.
- Import-eksport dhe shitje-blerje me shumicë dhe pakicë të karburanteve e lubrifikantëve.
- Import-eksport dhe shitje-blerje me shumicë dhe pakicë të makinave dhe autovecurave të të gjitha llojeve e tonazheve.
- Blerje pjesëmarrjeje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, ente konsorciume, të themeluara apo në themelim, të cilat mund të kenë objekt të ngjashëm ose sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritjes së qëllimit të shoqërisë.
- Të shërbejë si përfaqësuese shitjeje e marketingu, agjent shitje për shoqëri vendase dhe të huaja, të angazhohet në shitje me shumicë dhe pakicë dhe të hapë dyqane për këtë qëllim, degë apo zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë.
- Shoqëria mund të bëjë ose mund të kërkojë regjistrimin në emër të saj, të transferojë apo të tregtojë si të njëjta, patenta e të drejta autori, marka të ndryshme, marketingu, licenca, tituj tregtie si dhe të drejta të ngjashme intelektuale dhe industriale.
- Import-eksport dhe shitje-blerje me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore, lëndëve të para, cigare, medikamente mjeksore, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitare, hidraulike, duraluminit, pllakave të të gjitha llojeve, plastikës, gomës, bimëve mjeksore, lëndës drusore e mobiljeve të linjave të prodhimit e përpunimit, konfeksioneve, por pa u kufizuar veten në këto.
- Veprimtari në fushën e turizmit, me qëllim jo vetëm ngritjen por edhe shfrytëzimin dhe zhvillimin e veprimtarive në fushën e hotelërisë dhe të fshatrave turistike të pushimit, qendrave të argëtimit, brenda dhe jashtë vendit, si dhe të blejë, të marrë dhe të japë me qera, të ndërtojë apo të nxisë

ndërtimin e tyre, duke vepruar në këtë fushë apo me partnerë të tjerë Bar- restorant, veprimtari në fushën e argëtimit, si salla pingpongu, bilardoje dhe lojra të tjera argëtuese.

- Vendosja në dispozicion të klientelës, ambiente të përshtatshme për të prezantuar mallrat tregtarëve, mediatorëve dhe biznesmeneve të interesuar për shitblerjen e mallrave të ndryshëm.
- Shoqëria mund të kryejë çdo veprim që ka të bëjë me pasurinë e palujtshme, të luajtshme apo financiare që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, ëprfshirë këtu, por pa u kufizuar në to, nënshkrimin dhe marrjen e kredive me institucione të autorizuara nga ligji, individë si dhe me shoqëri apo sipërmarrje private.
- Më në përgjithësi shoqëria do të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë

NENI 5

Selia e shoqërisë dhe afati

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Tiranë Kashar Katund i Ri, Autostrada Tiranë- Durrës, Km. 7, pranë ish Radiostacionit.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë në vlerën 100 000 njëqind mijë lekë lekë dhe është i ndarë në 5 kuota.

NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare “Billa Home” Sh.p.k. dhe zotërimi i kuotave nga secili në këtë shoqëri është si mëposhtë:

Shefqet Billa, i biri i Arifit i datëlindjes 11.01.1952, i cili zotëron 1 Kuotë me 28% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 28 000 lekë.

Jetmir Billa, i biri i Shefqetit i datëlindjes 19.05.1983, i cili zotëron 1 Kuotë me 15 % në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 15 000 lekë.

Ideal Billa, i biri i Shefqetit i datëlindjes 16.08.1979, 1 Kuotë me 25.5% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 25 500, lekë.

Arif Billa, i biri i Shefqetit i datëlindjes 02.04.1987, i cili zotëron 1 Kuotë me 25.5% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 25 500 lekë.

Zj. Arjeta Billa e bija e Shefqetit e datëlindjes 16.08.1990 e cila zotëron 1 Kuotë me 6 % në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 6 000 lekë.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

NENI 8

Menyra e funksionimit te shoqerise

Shoqëria do të funksionojë si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në baze të statutit të shoqërisë i cili hartohet mbështetur dhe në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe do të zbatohet ligjin 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe të legjislacionit tjetër në Shqipëri.

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si mëposhtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat 5 vjet nga regjistrimi në QKB, me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Ideal BILLA. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori.

NENI 10

Të tjera

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ruajtja e sekretit

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Nënshkrimi

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejte.

NENI 14

Dispozita te fundit

Kjo kontrate per themelimin e shoqerise hartohet në gjuhën Shqipe dhe ne 5 kopje te barabarta.

ORTAKET THEMELUES

| | | |
|--|---|---|
| Shefqet BILLA  | Jetmir BILLA  | Ideal BILLA  |
| Arif BILLA  | Arjeta BILLA  | |